VENDIM
Nr. 117/2025

PËR MIRATIMIN E ORGANIKËS DHE KLASIFIKIMIT TË PAGAVE TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË PAS MBARIMIT TË MANDATIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

Në mbështetje të neneve 78, 179/b, pika 8, të Kushtetutës, neneve 18, pika 1, 70, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neneve 18 dhe 55 të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratimin e organikës dhe klasifikimit të pagave të punonjësve administrativë pas mbarimit të mandatit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 18.6.2026 deri në datën 31.12.2026.

KRYETAR
Niko Peleshi

Miratuar në datën 18.12.2025.

Lidhja nr. 1

ORGANIKA DHE KLASIFIKIMI I PAGAVE TË PUNONJËSVE ADMINISTRATIVË PAS MBARIMIT TË MANDATIT TË KOLEGJIT TË POSAÇËM TË APELIMIT

FUNKSIONI ORGANIK	**Klasifikimi i pagës**	**Numri**
I. SEKRETAR I PËRGJITHSHËM	**I-1**	**1**
II. DREJTORIA E MENAXHIMIT TË ÇËSHTJEVE DHE MARRËDHËNIEVE ME MEDIAN DHE PUBLIKUN		**(15)**
Drejtor	I-4	1
Specialist sekretarie gjyqësore	IV-1	8
Specialist për zbardhjen dhe redaktimin e vendimeve	IV-1	3
Përkthyes	II-1	1
Koordinator për median dhe marrëdhëniet me jashtë	II-1	1
Specialist pritjeje me popullin	IV-1	1
III. DREJTORIA EKONOMIKE DHE E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE		**(12)**
Drejtor	I-4	1
Specialist financë/buxhet	IV-1	1
Specialist i burimeve njerëzore	IV-1	1
Specialist IT *	IV-1	2
Specialist protokoll/arkivi **	IV-1	2
Magazinier	VI	1
Punonjës pastrimi	II	2
Shofer/korrier	V	1
Punonjës mirëmbajtje	III	1
Total		**28**

Shënim.

** Punonjësit në pozicionin e specialistëve të teknologjisë së informacionit përfitojnë shtesën për natyrë të veçantë pune në masën dhe sipas kushteve të përcaktuara në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

*** Punonjësit në pozicionet specialist arkivi, përfitojnë shtesë për kushte të vështira e të dëmshme për shëndetin sipas kushteve dhe masës së përcaktuar në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e nëpunësve civilë në administratën shtetërore dhe institucione të tjera të pavarura.*

**** Përfitimet për kushtet e vështira e të dëmshme të shëndetit për punonjësit mbështetës janë sipas përcaktimeve në vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore*

***** Punonjësit administrativë përfitojnë shtesën mujore për natyrë të veçantë pune në masën 10% të pagës për pozicion apo të pagës bazë për klasë. Punonjësit administrativë, të cilët sipas këtij vendimi përfitojnë shtesa të tjera të së njëjtës natyrë të përcaktuara në të, do të përfitojnë vetëm njërën prej shtesave, atë me vlerën më të madhe.*